



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 66/2 Prot.

Tiranë, më 21.03.2023

VENDIM
Nr. 27, datë 21.03.2023

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 90, DATË 28.6.2022

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit nr. 90, datë 28.6.2022, të Komisionerit, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes tematike në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në institucionin e varësisë të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, dhe paralajmërimin e Institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të planit vjetor të mbikëqyrjes dhe me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionet që përfshihen në këtë fushë, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur

fillimin e mbikëqyrjes tematike në institucionin Agjencia Kombëtare e Bregdetit me vendimin nr. 122, (987/1 prot.), datë 14.10.2021, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes tematike në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe në Departamentin e Administratës Publike”*.

Ky proces është përmbyllur me vendimin nr. 90, datë 28.6.2022, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes tematike në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në institucionin e varësisë të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe paralajmërimin e Institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, institucionit, i është kërkuar informacion në lidhje me ecurinë e zbatimit tij nëpërmejt shkresës me nr. 776/3 prot., datë 12.12.2022, me lëndë: *“Mbi zbatimin e vendimeve paralajmëruese të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”*. Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka njoftuar Komisionerin mbi masat e marra në zbatim të këtij vendimi duke vënë në dispozicion shkresën me nr.3176/1 prot., datë 20.12.2022, *“Kthim përgjigje”*, protokolluar me tonën me nr. 776/9 prot., datë 22.12.2022. Njëkohësisht, me e-mailin e datës 23.06.2022, të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, janë dërguar aktet që provojnë zbatimin e detyrave të lëna.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 90, datë 28.6.2022, dhe gjetjet e specifikuar në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil për rastin në fjalë paraqitet si më poshtë vijon:

Në pikat 2 dhe 3 të dispozitivit të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, që t'i dërgojë zyrtarisht Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit formularin e vlerësimit të punës për titullarin e institucionit, për nëpunësin ***** dhe mandej, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të plotësojë formularin e vlerësimit të punës dhe ta dërgojë atë zyrtarisht pranë njësisë përgjegjëse (DAP) me qëllim që të vijojnë procedurat e parashikuara në pikën 5, të vendimit nr. 109, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultatve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar, lidhur me vlerësimin e anëtarit të TND-së, ***** nga Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes (KKP).

Konstatohet se, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, me shkresën nr.3176/1 prot., datë 20.12.2022, *“Kthim përgjigje”*, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet

administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Konkretisht, nëpërmjet shkresës me nr. 1369/3 prot., datë 27.7.2022, Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka dërguar pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, formularin e vlerësimit të punës për 6-mujorin e parë të vitit 2022, për nëpunësin ***** në pozicionin “*Drejtor i Përgjithshëm*”.

Në përgjigje të shkresës së mësipërme Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ia ka dërguar të plotësuar formularin e vlerësimit për këtë nëpunës, Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, nëpërmjet shkresës me nr. 5978/1 prot., datë 4.8.2022.

Nga komunikimi me njësinë e burimeve njerëzore të Ministrisë, jemi informuar se pranë DAP është depozituar shkresa me nr. 781 prot., datë 1.2.2023, me anë të së cilës është dërguar formulari i vlerësimit për nëpunësin në fjalë së bashku me vlerësimet e tjera të nëpunësve anëtarë të TND. Në këto rrethana, DAP të vijojë procedurën, për të përmbyllur vlerësimin nga KKP.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 90, datë 28.6.2022, të Komisionerit, “*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes tematike në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në institucionin e varësisë të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, dhe paralajmërimin e Institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë*”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Agjencia Kombëtare e Bregdetit, duke zbatuar detyrat e Vendimit paralajmërues nr. 90, datë 28.6.2022.
3. DAP të vijojë procedurën, për të përmbyllur vlerësimin nga KKP, proces i cili do të verifikohet në mbikëqyrjen pasardhëse.

4. Për këtë vendim të njoftohet Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, DAP dhe nëpunësi *****.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha